Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Xhevdet Bushi, ***Eksperti shqyrtues i jashtëm***	**28.06.2022**	**08.07.2022**	Nr. i lëndës: **231/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.06.2022, OE. "CV" – Prishtinë , ka parashtruar ankesë me nr: **231/22**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-se, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndermarrjes Publike Banesore"** me nr te prokurimit: **1909466981031194-22-2679-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **NDERMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A (NPB)**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Sherbime**, vlera e parashikuar e kontratës: **23,600.00 €**.

SHENIM: (Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i **OSHP-së**)
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues..

TE DHENAT MBI AKTIVITETIN E PROKURIMIT

Njoftim per Kontrat eshte publikuar me 31.03.2022 respektivisht 01.04.2022
Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara eshte publikuar me datat 23.04.2022 dhe 25.04.2022 00:00 00:00
Proces verbali i hapjes se Tenderve me datë 06.05.2022 14:04
Njoftimi mbi vendimin e AK ku jemi eliminuar është i datës: 27.05.2022 15:25
Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar permes platformes se e-prokurimit me date 30.05.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK për pezullim i datës: data 01.06.2022 ora 13:59
Njoftimi mbi vendimin e AK Vendimi per shqyrtimin e kërkesës i datës: 02.06.2022 ora 13:59
Njoftimi mbi vendimin e AK ku jemi eliminuar është i datës: 14.06.2022 14:44
Kerkesa per rishqyrtim eshte dorezuar permes platformes se e-prokurimit me date 18.06.2022
Njoftimi mbi vendimin e AK për pezullim i datës: data 20.06.2022 ora 14:26
Njoftimi mbi vendimin e AK Vendimi per shqyrtimin e kërkesës i datës: 20.06.2022 ora 15:35

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE – 231/22

Shpallja e procedurës ne e-prokurim:

Dispozitat e shkeluara te AK-se

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/nuk janë te njëjta.

Pretendimet ankimore te OE ankues

Ankesa është e ndarë në dy pjesë

1. Pjesa e parë - AK – NPB e ka eliminuar ofertën tone në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP
2. Pjesa e dytë AK – NPB ka shpallur fituese ofertën e OE ne kundërshtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP pasi është i papërgjegjshëm si dhe me çmim më të lartë për rreth 6000 euro).

PJESA E PARË E ANKESES
AK – NPB E KA ELIMINUAR OFERTËN TONE NË KUNDËRSHTIM ME DISPOZITAT E LPP DHE RRUOPP

Pika 1: Lidhur me pretendimin e AK se:
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave te dhena ne njoftimin e kontratës dhe në *dosjen e tenderit*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyejes si në vijim: *Tenderi i juaj* është administrativisht/teknikisht i papërgjegjshëm: Per arsye se: Lista e projekteve te dorezuara nga OE nuk e permbushe kerkesen 2 te kapacitetit teknik dhe professional te dosjes se tenderit. OE ka dorezuar nje liste pa vlera e cila nuk e permbush kerkesen e dosjes se tenderit dhe përveç listes nuk ka bashkangjitur as dëshmitë siç janë referencat pozitive. OE po ashtu ka dorezuar listen e stafit me gjithesej 8 punotorë: 4 vlerësues, 3 kontabilist te certifikuar dhe një Gjeodet. Në mesin e 4 vlerësuesve e ka prezantuar edhe Bujar Prestreshi, për te cilin ka bashkangjitur CV-në e nënshkruar dhe referenca ku dëshmonë se i njejti është i vetëpunsuar në kompaninë Vizatimi shpk, por nuk ka te bashkengjitur kontrate valide ose parakontraten në mes Bujar Prestreshi dhe OE CV shpk, mbi kete fakt nuk e permbush kerkesen 1 nen piken C te kapacitetit teknik dhe professional sepse jan kerkuar minimum 4 vlerësues te shkalles se parë me kontrata valide ose parakontrate ndersa OE- CV-shpk ka vetem 3 vlerësues dhe nuk e permbushë kriterin e dosjes se tenderit.
NE DEKLAROJMË se kjo nuk qëndron nga fakti se ne kemi çmimin më të ulët nga tenderët qe i plotësojnë kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

FAKTIMI

Pika 1 – paragrafi 1 - Sa i përket pikës së parë rreth listës së projekteve kjo nuk qëndron sepse lista e projekteve kalon shumën e kërkuar dhe është dorëzuar e kompletuar së bashku me dëshmitë:

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:

është kërkuar - Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme siç janë; (vlerësimi i pasurisë, objekteve dhe qirave), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë jo më pak se 30,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Një listë te sherbimeve të realizuara në 3 vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke saktësuar sherbimet e kryera , shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur sherbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi shërbejnë (referenca pozitive ose raporti i pranimit te sherbimit) të lëshuar ose të bashkë-nënshkruara nga autoriteti i tillë; **(ii) kur sherbimet janë kryer për një person kompani private, <u>për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi siç janë</u>; (referenca pozitive, raportet e pranimit <u>apo kontrata</u>), por që këto dokumente të jenë të pranueshme duhet të dëshmohen me (transaksion bankar).**

GJETJET - SHKELJET E AK PËR TË NA ELIMINUAR KUNDËRLIGJSHËM

Ne kemi ofruar listën e kontratave me dëshmi kontrata si dhe transaksionet bankare që dëshmojnë se ne kemi se kemi përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme ne vlere prej mbi 30,000 apo mbi 100,000 Euro siç janë, (vlerësimi i pasurisë, objekteve dhe qirave),

Shih deklaratën me listen e kontratave dhe transaksione bankare

CV Biznes # 810822305
Fiskal # 600900337
TVSH # 330183682

Ne ofrojmë dëshmi se kemi përfunduar dhe punojmë me sukses kontrata të natyrës së ngjashme siç janë, (vlerësimi i pasurisë, objekteve dhe qirave), dhe në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, ku ofrojmë dëshmi me mbi 100,000 Euro e qo jane vlerë trefish më shumë se vlera e kërkuar prej 30,000.00 €.

Ofrojmë dëshmi me mbi trefishin e vlerës se kërkuar

- Kontratat me bankën Procredit
- Kontratat me bankën TEB
- Kontrata me Raiffeisen
- Pagesat e faturave në xhirollogari qe kalojnë shumen e paguar për vlerësime të pronave në vlere mbi 100,000 Euro ne tri vitet nga vetëm dy klient (Procredit dhe TEB).

AK gjatë vlerësimit nuk i ka marr parasysh fare kontratat e as transaksionet bankare të prezantuara në ofertë ku shumat dhe datat e sakta dhe dokumentimi e datës së pranimit dhe të gjitha nëpërmes xhirollogarisë bankare. Ne gjithashtu i kemi bashkangjitur edhe kontratat, dhe pagesat e kryera ku në kontratë ceket se pagesa behët vetëm pasi të është bërë pranimi i raporteve. Janë dorëzuar gjithsej 30 faqe të transaksioneve bankare janë dorëzuar si dhe 34 faqe me kontratat e natyrës se njëjtë ku shihen te gjitha detajet, data, shuma dhe koha e pranimit dhe pagesës.

Data e pranimit	Data e ekzekutimit		Fatura për shërbimet e kryera/Pozitive			shuma mujore	
5/2/2020	6/2/2020	9:43	TEB21/01/2020 TEB-20-01C shuma e numrit të faturës	EUR	0	2,293.75	760
27/02/2020	28/02/2020	11:04	TEB 21/02/2020 TEB-20-0028 shuma e numrit të faturës	EUR	0	893.5	763
27/02/2020	28/02/2020	11:30	TEB 21/02/2020 TEB-20-02C shuma e numrit të faturës	EUR	0	4,278.75	800

Model: Konfirmim i pagesave per shërbimet e kryera te ngjashme pozitive për një muaj

408	497893950	28.10.2019	0.00	6,516.50	Ekzekutim i pagesave masive- Llogarite internale Transferte brenda bankës	CV SHPK 70906524 EUR/LLOGARI RRJEDHESE :1185005590000117;PCB-Fat. PCB19-10P, Vleresimi i pronave per muajin Shtator 2019;MultipleDebitAccounts:860000 01152978.1152
409	497893949	28.10.2019	0.00	154.00	Ekzekutim i pagesave masive- Llogarite internale Transferte brenda bankës	CV SHPK 70906524 EUR/LLOGARI RRJEDHESE :1185005590000117;PCB-Fat.L-PCB19-10, Vleresimi i pronave te luajtshme per muajin Shtator 2019;MultipleDebitAccounts:860000 01152978.1152
445	492061983	27.08.2019	0.00	3,157.00	Ekzekutim i urdhërpagesës Transferte brenda bankës	PCB-Fat.PCB19-055, Vleresimi i pronave Repossessed per muajin korrik2019

Bankat janë institucione private dhe AK ka kërkuar njërën nga këto dëshmi (referenca pozitive, raportet e pranimit **apo kontrata)** **të dëshmuara me (transaksion bankar)** dhe ne kemi ofruar kontratat e nënshkruara nga blerësi si dhe transaksionin bankar për faturën e paguar (për vlerësime) si dëshmi se kemi kryer punën suksesshëm. Gjithashtu, AK ne DT nuk ka ofruar asnjë forme apo model tabelare për te listuar projektet.

Prandaj, AK ka shkelur ligjin kur na ka shpallur të papërgjegjshëm sepse Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar i përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar dhe e kalon atë për mbi tri herë.

PROVAT:

a) Kontratat e dorëzuara (34 faqe) me te gjitha detajet e kërkuara,
b) Transaksionet bankare (30 faqe) me te gjitha detajet e kërkuara,
c) Deklarata përmbledhëse me te gjitha detajet e kërkuara
d) *DOKUMENTACIONI I DORËZUAR – Oferta/Tenderi*

Pika 1 – paragrafi 2 - Sa i përket pikës së dytë se kinse kam ofruar vetëm 3 vlerësues kjo nuk qëndron për faktin se ne kemi dorëzuar dokumentacionin qe fakton se z. Bujar Prestreshi do të jetë i angazhuar në këtë projekt dhe është dorëzuar së bashku me dëshmitë:

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:

është kërkuar –

që OE duhet të prezentojë stafin e nevojshëm **min 08** punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi duhet të jete i diplomuar ose çertifikuar licencuar. Profilet e punëtorëve që kërkohen janë si në vijim:

Kërkesa c) Min katër (4) punëtor të certifikuar licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit certifikimit licencimit)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Një Listë me numrin e punëtorëve që angazhohen për kryerjen e sherbimeve, minimum. 08 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani – **duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik**
b) Dëshmia për vlerësues, CV-ja kopje e nënshkruar nga Vlerësuesi, diploma ose certifikata ose licenca kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose parakontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi).

GJETJET - SHKELJET E AK PËR TË NA ELIMINUAR KUNDËRLIGJSHËM

Ne kemi ofruar referencat si ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi dhe referencën nga firma CV shpk ku dëshmon se është i angazhuar si vlerësues, si dhe është paraqitur në listën e stafit te nënshkruar ne origjinal nga ne, CV e nënshkruar nga vet Bujar Prestreshi se bashku me licencën dhe referencat tjera, si dhe paraqesim para kontratën dokumente këto lehte te verifikohen që vërtetojnë se z. Bujar Prestreshi që përpos qe punon ne firmën e vet është i angazhuar nga CV shpk ku AK nëse ka pasë të pakjart ka mundur të kërkojë sqarime shtesë. Ne nuk mashtrojmë por e deklarojmë të vërteten. AK gjatë vlerësimit nuk i ka marr parasysh fare CV e nënshkruar nga vet Bujar Prestreshi, nuk e ka marr parasysh as licencën, nuk e ka marr parasysh as listën e punëtoreve të propozuar dhe nënshkruar nga ne në origjinal, nuk e ka marr parasysh e as dhe letër-konfirmimin ku vërtetohet se z. Prestreshi është i angazhuar nga ne si dhe as nuk e ka përdorë obligimin ligjor të kërkojë sqarime shtesë për të konfirmuar.

Shih deklaratën në origjinal për angazhim te personelit

Dëshmia e Kapaciteti teknik dhe profesional ku prezantojmë stafin e nevojshëm min oë punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi është i diplomuar ose çertifikuar dhe licencuar. Profilet e punëtorëve janë si në vijim:

Nr.	Emri dhe mbiemri	mosha e punëtorit	profesioni	eksperienca (vite)	pozicioni në kompani
1.	Valdet Osmani	48	Vlerësues / Arkitekt	24	Vlerësues i licencuar kat IA
2.	Bujar Prestreshi	46	Vlerësues / Arkitekt	22	Vlerësues i licencuar kat IA
3.	Aderim Musliu	40	Vlerësues / Ekonomist	12	Vlerësues i licencuar kat IA
4.	Saranda Sadriu-Mehmeti	37	Vlerësuese / Auditore	10	Vlerësues i licencuar kat IA
5.	Urim Osmani	43	Kontabilist të çertifikuar	14	Kontabilist të çertifikuar
6	Ngadhnjim Sheremeti	36	Kontabilist të çertifikuar	10	Kontabilist të çertifikuar
7.	Valon Damoni	42	Kontabilist të çertifikuar	14	Kontabilist të çertifikuar
8.	Edona Sheqerolli	34	Gjeodete	10	Gjeodete

Shih letër konfirmimin se Bujari është i angazhuar

CV sh.p.k.
Mat I. Obj I / Nr 51
Prishtinë 02.02.2022
10000, Kosovë

Letër Konfirmim – Referencë për shërbime të kryera

Në emër të kompanisë CV shpk, ju konfirmoj që Bujar Prestreshi me licencë nr. VP 20 për vlerësimin e pronave të paluajshme është angazhuar nga kompania CV shpk si vlerësuese i licencuar dhe ka kryer **raporte të vlerësimit** të cilat janë konfidenciale dhe mund ti kërkoni nga bankat TEB dhe Pro Credit.

Për më shumë informacione, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni dhe/apo shkruani apo edhe Banken Pro Credit, Bankën TEB apo bankën Qendrore ku z. Bujar Prestreshi figuron si Vlerësues për nevojat e bankave komerciale ne Kosovë.

Valdet Osmani, ms
Drejtor/Vlerësues i Pronave te Paluajshme VP-041
t. 044699 122 331
CV sh.p.k.
Mat I. Obj I / Nr 51, Prishtinë, 10000, Kosovë

Prove se para kontrata është para dorëzimit të ofertës

Raporti i ekspertit shqyrtues,lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "CV" – Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit:**" Vlerësimi i Pronave dhe Qirave të Ndermarrjes Publike Banesore"** me nr te prokurimit: **22-2679-2-2-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – **Ndermarrja Publike Banesore (NPB)**



Edhe dokumenti i dorëzuar i referohet para kontratës

Bujar Prestreshi CV me referenca licenca parakontrata.pdf - Adobe Acrobat Professional

Prandaj, AK ka shkelur ligjin kur na ka shpallur të papërgjegjshëm sepse ne kemi ofruar të gjithë personelin sipas kërkesës se dosjes se tenderi dhe përmbushim kërkesat minimale sipas dosjes se tenderit.

PROVAT:

a) Lista e dorëzuar ne origjinal ,
b) CV e nënshkruar, katër referenca, licenca me te gjitha dëshmitë e kërkuara ,
c) Parakontrata e datës 21.04.2022 e skanuar me 06.05.2022
d) DOKUMENTACIONI I DORËZUAR – Oferta/Tenderi
e) Vet dokumenti i dorëzuar i referohet para kontratës

PJESA E DYTË E ANKESES

PIKA 2: 2. AK – NPB KA SHPALLUR FITUESE OFERTËN E OE NE KUNDËRSHTIM ME DISPOZITAT E LPP DHE RRUOPP PASI ËSHTË I PAPËRGJEGJSHËM SI DHE ME ÇMIM MË TË LARTË PËR RRETH 6000 EURO).

Lidhur me pretendimin e AK se në formularin B58-Njoftim mbi vendimin e Autoritetit kontraktues ku *"Ndërmarrja Publike Banesore sh.a. shpërblen me kontratë*

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **Pro Acc Group SH.P.K., Rruga Venet Bajrami, Blini 2, Hymja-A, Nr.25. 10000. Prishtinë** vlerë totale të ofertës **23,482.00€**

me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" **NE DEKLAROJMË se kjo nuk qëndron nga fakti se ne OE i shpërblyer nuk i plotëson kriteret dhe është i papërgjegjshëm** por edhe po të ishte i përgjegjshëm e ka çmimin më të lartë në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Faktet dhe provat se AK - NPB ka shpallur fituese ofertën e OE ne kundërshtim me dispozitat e LPP dhe RRUOPP sepse OE është i papërgjegjshëm:

Me datën 14.06.2022 kemi bërë kërkesën për qasje në dokumente ndërsa me datën 15.06.2022 na është dhënë e drejta e qasjes ku ne kemi kërkuar të gjithë ofertën dhe dokumentacionin e OE të shpërblyer por AK na ka refuzu kërkesën pasi ka deklaru se kinse oferta e OE qenka sekret afarist por pa dhënë arsyetimin se pse jenë prandaj kemi pasur qasje te limituar dhe dokumentacioni i kërkuar nuk na është dhënë por disa i kemi shikuar ne "kompjuter" dhe për një kohë të shkurtë kohore si dhe me qasje të limituar kemi gjetur shkeljet dhe provat duke i evidentuar shkeljet ligjore. Ne do të faktojmë në bazë dhe renditjen sipas kërkesave të njoftimit dhe dosjes së tenderit si më poshtë.

Provat dhe faktet:

1. **Shkeljet e evidentuara dhe mos përmbushja e Kërkesave e përshtatshmërisë:**

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:

është kërkuar deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) **Deklarata e nënshkruar dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit.**

GJETJET - SHKELJET DHE MOS PËRMBUSHJA E KRITEREVE

OE-i propozuar ka ofruar deklaratë të rrejshme sepse nuk është i përshtatshëm dhe se përmban elemente mashtruese tek personeli nga lista e propozuar ku figurojnë kontrata me përmbajte mashtruese dhe në kundërshtime me ligjin LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS si dhe disa nga referencat për personelin u duken me përmbajte të pavërtetë. Ndërsa te i ashtuquajturi gjeodeti ka prezantuar licencën e një kompanie e jo te personit qe të vë në lajthitje dhe mashtrim AK sepse personi i propozuar nuk është i licencuar si gjeodet. Gjtihashtu, kontratat dhe disa dokumentet tjera nuk kane emrat e personave te autorizuar për nënshkrim me qëllim hutimi, mashtrimi dhe vënie në lajthitje AK si dhe disa CV janë dorëzuar në gjuhen angleze edhe pse dosja e tenderit ka qene vetëm në gjuhen shqipe dhe serbe..

PROVAT:

a) CV e personelit nga lista e propozuar me te ashtuquajturat referenca,
b) Kontratat me personelin e propozuar nga OE
c) Oferta e dërguar e OE

2. **Shkeljet e evidentuara dhe mos përmbushja e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale / Kapaciteti teknik dhe profesional:**

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:

është kërkuar që OE duhet të prezentojë stafin e nevojshëm min 08 punëtor që do të angazhohen në këtë projekt, i gjithë stafi duhet të jete i diplomuar ose çertifikuar licencuar. Profilet e punëtorëve që kërkohen janë si në vijim

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Një Listë me numrin e punëtorëve që angazhohen për kryerjen e sherbimeve, minimum. 08 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani – **duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.**

GJETJET - SHKELJET DHE MOS PËRMBUSHJA E KRITEREVE

OE-i propozuar nga AK nuk e ka përmbushur këtë kriter pasi ka dorëzuar listën **NË KOPJE** e jo sic është cekuar në DT ku është e cekuar eksplicit **"duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik"** . Prandaj, OE do te duhej te shpallej i papërgjegjshem.

PROVAT:

A) Në oferte është dorëzuar vetëm kopja.

3. **Shkeljet e evidentuara dhe mos përmbushja e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:**

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:

është kërkuar që OE duhet të ofroj Min tre (3) Kontabilist të çertifikuar- me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

b) Dëshmia për Kontabilist, CV-ja kopje e nënshkruar nga Kontabilisti, diploma ose certifikata kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose parakontratë, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi.

GJETJET - SHKELJET DHE MOS PËRMBUSHJA E KRITEREVE

OE-i propozuar nga AK nuk e ka përmbushur këtë kriter pasi disa nga personat e propozuar nuk kanë përvojë pune profesionale si Kontabilist dhe nuk dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi. Prandaj CV-të nuk i përmbushin kriteret dhe kërkesat prandaj është i papërgjegjshëm. Personeli i propozuar janë: Hysen Ramabaja, Lulzim Krasniqi dhe Burim Selmani Ku për dy te paret **nuk është ofruar licenca për kontabilist te certifikuar** dhe as referencat dhe dëshmitë se kane përvojë të tillë.

Për z. Hysen Ramabaja është ofruar reference për përvoje pune si auditor sikurse edhe vet deklarimi dhe CV e jo si kontabilist. Si dhe nuk është ofruar licenca për kontabilist te certifikuar.

Për z. Lulzim Krasniqi nga CV dhe referencat shihet se nuk ka përvojë si kontabilist por edhe referenca e dorëzuar nuk e dëshmon punën dhe përvojën si kontabilist. **Gjithashtu, biznesi i udhëhequr dhe nga ai figuron i shuar. (shih ne ARBK). Pra, Lulzimi ka provojë akademike.** Si dhe nuk është ofruar licenca për kontabilist te certifikuar.

Lulzim O. Krasniqi B.I.	N.SH. " ADVANCED BUSINESS CONSULTING "	810904640	Prishtine	Biznes individual	Shuar

Ndërsa tek një biznes tjetër me tjetër pronar nuk figuron si i punësuar.

Për z. Burim Selmani është ofruar reference dhe kontrate për përvoje pune kinse tek OE porse në ARBK (https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,120439) figuron si pronar dhe i vetëpunësuar në BORA SH.P.K..
Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik përcaktojnë se në këto raste "CV i kërkuar nuk i përmbushë kërkesat dhe tenderi duhet refuzuar".

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Prandaj, CV-te nuk i përmbushin kërkesat, referencat, kontratat dhe para kontratat nuk janë në përputhje me ligjin dhe ligjin e punës dhe se OE nuk e ka ofru dokumentacionin e kërkuar e as të gjithë personelin prej 3 kontabilistëve të certifikuar me përvojën e kërkuar dhe si i tillë OE është i papërgjegjshëm.

PROVAT:

a) CV-të dhe referencat, parakontratat

b) Provat nga ARBK

4. Shkeljet e evidentuara dhe mos përmbushja e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:
është kërkuar që OE duhet të ofroj Min katër (4) punëtor të certifikuar licencuar si vlerësues të shkallës së parë, me së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit certifikimit licencimit).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

c) Dëshmia për vlerësues, CV-ja kopje e nënshkruar nga Vlerësuesi, diploma ose certifikata ose licenca kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose parakontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi.

GJETJET - SHKELJET DHE MOS PËRMBUSHJA E KRITEREVE

OE-i propozuar nga AK nuk e ka përmbushur këtë kriter ku si vleresues i ka paraqitur peronat si: Behar Jonuzi, Lorida Sylejmani, Arian Shala dhe Arben Bajrami por nuk kane dorëzuar letër referencë ku për disa nuk dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi i vërtet e që vërtetojnë përvojën e punës. Gjithashtu CV-t e dorëzuara nuk i përmbushin kërkesat e DT sepse nuk tregojnë dëshmitë për përvojën e kërkuar profesionale, ka të dhëna të pavërteta, si dhe janë në gjuhen angleze që paraqet shkelje pasi tenderi është në gjuhën shqipe dhe serbe si dhe punëdhënësit e deklaruar janë lokal.

a) Në CV-n e **Arian Shala** thuhej se është punëtor i bankës BPB-së dhe OE ku e ka paraqitur edhe kontratën si punëtor edhe të OE si dhe referencën e ka lëshuar vet OE, pra po del kinse punon paralelisht në dy vende pune nga viti 2017 gjë qe nuk është e mundur por **është mashtrim nga të dy palët**. Nga kjo rezulton se kontrata nuk është në përputhje me Dosjen e Tenderit e as me ligjin dhe ka përmbajtje dhe deklarate të pavërtetë sikurse **edhe vet referenca** pasi i njëjti nuk mund të punojë ne njëjtin orar dhe kohe ne te dy punët si dhe është konflikt interesi pasi OE e ka paraqit edhe kontratën me BPB ku punon vet Arian Shala i cili edhe i mbikëqyrë vlerësimet dhe një dëshmi se OE përdorë veprime te kundërligjshme.

b) Në CV-n e **Arben Bajramaj** thuhej se është punëtor i Bankës Ekonomikë te Kosovës-së ndërsa OE ku e ka paraqitur edhe kontratën si punëtor edhe të OE si dhe referencën e ka lëshuar vet OE pra po del kinse punon paralelisht në dy vende pune dy vende pune nga viti 2017 gjë qe nuk është e mundur por **është mashtrim nga të dy palët**. Nga kjo rezulton se kontrata nuk është në përputhje me Dosjen e Tenderit e as me ligjin dhe ka përmbajtje dhe deklarate të pavërtetë sikurse **edhe vet referenca** pasi i njëjti nuk mund të punojë ne njëjtin orar dhe kohë në të dy punët si dhe është konflikt interesi pasi OE e ka paraqit edhe kontratën me BEK ku punon vet Arben Bajramaj i cili edhe i mbikëqyrë vlerësimet dhe një dëshmi se OE përdorë veprime te kundërligjshme. **I njëjti ka qenë edhe zyrtar i NPB apo i AK ne prokurim dhe financa dhe njihen me zyrtaret e NPB-se.**

c) Në CV-n e Lorida Sylejmani thuhet se është punëtore e OE ku e ka paraqitur edhe kontratën si punëtore si dhe referencën e ka lëshuar vet OE. Nga kjo rezulton se kontrata nuk është në përputhje me ligjin e punës dhe ka përmbajtje dhe deklarate të pavërtetë sikurse **edhe vet referenca sepse nuk ka tri vite pune profesionale**. Nga lista e vlerësueseve e datës 21.04.2021 (https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EFA2B996-1DA1-43A6-896B-3826E8CEA771.pdf) rezulton se Lorida Sylejmani ka licencën pasive nga viti 2019 qe dëshmon se nuk ka përvojën e duhur dhe është paraqitur CV e rrejshme dhe kontrate mashtruese. Shih listën me numër rendor 280

279	[illegible]	[illegible]	OP 280 - Vlerësues i Shkallës së I-rë	[illegible]	[illegible]	[illegible]	Aktiv
280	[illegible]	[illegible]	OP 280 - Vlerësues i Shkallës së I-rë	[illegible]	[illegible]	[illegible]	Pasiv
281	[illegible]	[illegible]	OP 282 - Vlerësues i Shkallës së I-rë	[illegible]	[illegible]	17.11.2017-17.11.2019	Pasiv
282	[illegible]	[illegible]	OP 283 - Vlerësues i Shkallës së I-rë	[illegible]	[illegible]	17.11.2017-17.11.2019	Pasiv
283	[illegible]	[illegible]	OP 284 - Vlerësues i Shkallës së I-rë	[illegible]	[illegible]	17.11.2017-17.11.2019	Pasiv

Ligji i punës përcakton se si behën kontratat neni 10, 11 dhe 12 dhe këto kontrata me këta tre persona janë të kundërligjshme dhe me përmbajtje te rreme dhe se nuk janë nënshkruar sic kërkohet me ligj, por janë bërë me qëllim mashtrimi. Gjithashtu provë se kontratat kanë të njëjtët data te fillimit te punës dhe të mbarimit e qe nuk ka mundësi.

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik përcaktojnë se në këto raste "CV-ja e kërkuar nuk i përmbushë kërkesat dhe tenderi duhet refuzuar".

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Prandaj, CV-te nuk i përmbushin kërkesat, referencat nuk mbulojnë përvojën, kontratat dhe para kontratat nuk janë në përputhje me ligjin dhe ligjin e punës dhe se OE nuk e ka ofru dokumentacionin e kërkuar e as të gjithë personelin prej 4 vlerësuesve të certifikuar me përvojën e kërkuar dhe nuk i përmbush kriteret dhe kërkesat sipas DT dhe si i tillë OE është i papërgjegjshëm. Si dhe ka ofru deklarata të rreme dhe mashtruese duke shkelur deklaratën nën betim.

PROVAT:

a) CV-të e te gjithëve (gjuhen angleze),
b) Kontratat e kundërligjshme me përmbajtje të pavërtetë
c) Referencat
d) Nuk kane referenca nga punëdhënësit primar

5. Shkeljet e evidentuara dhe mos përmbushja e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

Kërkesa sipas dosjes së tenderit:
është kërkuar që OE duhet të ofroj Min një (1) Gjeodet të diplomuar min niveli Bachelor, më së paku 3 vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit).

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

d) Dëshmia për Gjeodet, CV-ja kopje e nënshkruar nga Gjeodeti, diploma kopje, kontrata valide e punës me punëdhënësin ose parakontrata, kopje. Si dhe letër Reference ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi.

GJETJET - SHKELJET DHE MOS PËRMBUSHJA E KRITEREVE

OE-i propozuar nga AK nuk e ka përmbushur këtë kriter sepse personi i propozuar nuk është i licencuar dhe nuk ka dorëzuar letër referencë ku dëshmohet përvoja e punës prej tri viteve e lëshuar nga punëdhënësi që vërtetojnë përvojën e punës. OE ka tentuar te mashtroj AK duke ofruar Licencën e kompanisë prandaj personi i propozuar **nuk e plotëson kriterin pasi ska licence valide dhe nuk e përmbush kriterin e përvojës profesionale pas diplomimit sepse nuk ka pune profesionale ngase nuk ka licence**. CV e dorëzuar nuk dëshmon se ka qene i licencuar dhe as që e ka përvojën profesionale trevjeçare pasi për përvoje profesionale duhet licence. Njëra reference ka përmbajtje të rreme pasi i referohet si inxhinier i Gjeodezisë e që nuk është.

Ligji i kadastrit dhe rregulloret ligjore përcaktojnë saktë se për pune profesionale gjeodezike dhe kadastrale gjeodeti duhet te jete i licencuar.
Shih përkufizimin:

1.1. **Gjeodet i licencuar** – nënkupton personin fizik të licencuar për kryerjen e punëve kadastrale dhe gjeodezike;

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik përcaktojnë se në këto raste "CV i kërkuar nuk i përmbushë kërkesat dhe tenderi duhet refuzuar".

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Prandaj, CV-te nuk i përmbushin kërkesat dhe se OE nuk e ka ofru dokumentacionin e kërkuar e as të gjithë personelin me përvojën e kërkuar dhe nuk i përmbush kriteret dhe kërkesat sipas DT dhe si i tillë OE është i papërgjegjshëm. Si dhe ka ofru deklarata të rreme dhe mashtruese duke shkelur deklaratën nën betim.

PROVAT:

a) CV dorëzuar me referenca (CV e datës 2018)
b) Licenca e dorëzuar e firmës të një personi tjetër

PRANDAJ DUKE U BAZUAR NË PROVAT SI MË LART ANKESA JONË TË PRANOHET DHE LËNDË TË KTHEHET NË RISHQYRTIM, RIVLERESIM DHE RIVENDOSJE.

DEMET MATERIALE:

Në këtë rast na është shkaktuar dëmi i drejtpërdrejt në përgatitjen e kërkesave dhe ankesës dhe kohen e përkushtuar në to si dhe do të dëmtohemi materialisht si ne aspektin financiar në fitimin e humbur, dëmet kontraktuale si dhe në dëmtimin e reputacionit te kompanisë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
a. **Deklarata** nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik Neni 65, duke përdorur formën në Aneksin b. **Një vërtetim** i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve, vërtetimi duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës; dhe c. **Vërtetim te** lëshuar nga gjykata apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65 të LPP-së, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, (jo me e vjetër se 6 muaj para datës datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	***a)Deklarata e nënshkruar*** *dhe e vulosur duke përdorur formën standarde në dosjen e tenderit.* ***b)Vërtetim nga ATK****-ja se nuk ka borxhe ndaj shtetit të Kosovës ose marrëveshjen me ATK, jo me i vjetër se 3 muaj nga data e shpalljes së tenderit. Kërkohet kopje* ***c) Vërtetimin nga Gjykata****- apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit* ***65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4, (kërkohet origjinali ose kopja e noterizuar)*** ***Dëshmitë lidhur*** *me kërkesat e pranueshmerisë si në pikën b dhe c, do të kërkohen vetëm nga tenderuesi i propozuar për nënshkrim te kontratës.* *Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur* ***është pesë (5)*** *ditë nga marrja e njoftimit të NPB-se për synimin e dhënies së kontratës.* *Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, b dhe c i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e garancionit për sigurim te ofertës dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe.* ***Në rast se tenderi*** *dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre në përputhje me Pjesën 6.4*

Përshtatshmëria profesionale	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
a.)**Regjistrimin** si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Çertifikata Regjistrimit të Biznesit(sipas formatit të ARBK-së) **b.Certifikata e TVSH,** bizeneset që nuk janë në TVSH mund të aplikojnë por para se të shpallen fitues duhet të dëshmojnë se janë regjistruar si deklarues të tvsh-së.	a) ***Një dokument*** *i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit me llojet e veprimtarisë);* b) ***Një kopje*** *e certifikatës së TVSH; ose dëshmi mbi regjistrimin e tvsh-së*
Kapaciteti ekonomik dhe Financiar	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
Kërkesa1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, ose grupit të OE-ve gjatë 3 viteve të shkuara ka qenë në vlerë, së bashku në të tri vitet, prej jo më pak **se 46,000.00 euro** Në rast të konzerciumit lideri duhet ta **përmbushë 60%** të vlerës	***Deklaratat Tatimore Vjetore*** *të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit,)* ***ose*** *Pasqyrat Financiare të audituara nga ndonjë firmë e njohur e licencuar për auditim ose auditor i pavarur i licencuar për tri vitet e shkuara (të bashkangjitet kopja e noterizuar e certifikatës së auditorit) Operatori ekonomik qe përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një, dy apo tri vite ka përmbushur kërkesën minimale te përcaktuar ne dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar*
Kapaciteti teknik dhe professional	***Dëshmia e kërkuar dokumentare:***
